



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.987/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj dhe Franciska Ymeri Zhitija, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit Bibita shpk me seli në fshatin Vitomiricë Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Kujtesa Nezaj Shehu dhe Valon Basha avokat nga Prishtina, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurisë Balkan Drinks LLC me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Arlinda Haziri avokate në Ferizaj duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.174/24 i datës 12.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit Bibita shpk me seli në fshatin Vitomiricë Komuna e Pejës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.174/24 i datës 12.04.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.174/24 datës 12.04.2024, ka Refuzuar në tërsi si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurisë Bibita shpk, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe ti ndalohet kundërshtarit të masës së sigurimit Balkan Drinks LLC, çdo aktivitet i cili shkel dizajnin industrial nr.209 dhe/apo markën tregtare të regjistruar nr.28291, përfshirë prodhimin, importimin, eksportimin, vendosjen në treg, shitjen apo magazinimin në qfardo mënyre të produkteve shkelëse si dhe të urdhërohet konfiskimi dhe largimi nga tregu i të gjitha produkteve që shkelin dizajnin industrial nr.209 dhe/apo markën tregtare 28291.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur përfaqësuesja e autorizuar e propozuesit të masës së sigurimit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimin e gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa, të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar ashtu që të aprovohet propozimi për shqiptimin e masës së përkohshme në tërsi apo të anulohet aktvendimi dhe ta kthejë lëndën në rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit Bibita shpk me seli në fshatin Vitomiricë Komuna e Pejës, pranë gjykatës, me datën 01.03.2024, ka paraqit padi kundër të paditures Balkan Drinks, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe ti ndalohet kundërshtarit të masës së sigurimit i cili shkel dizajnin industrial nr.209 dhe apo markën tregtare të regjistruar 28291, përfshirë prodhimin, importimin eksportimin, vendosjen në treg, shitjen apo magazinimin në çfardo mënyre të produkteve shkelëse dhe urdhërohet konfiskimi dhe largimi nga tregu i të gjitha produkteve që shkelin dizajnin industrial nr.209 dhe apo markën tregtare nr.28291.

Dhoma e shkallës së parë duke vendosur lidhur me propozimin e propozuesit të masës së sigurimit, ka caktuar seancën dëgjimore me datë 28.03.2024 dhe pas dëgjimit të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, ka marr aktvendimin e atakuar me të cilin ka refuzuar në tërsi si të pabazuar propozimin e paditësit/propozuesit të masës së sigurimit Bibita shpk, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij vendimi, Dhoma e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 68 të Ligjit për Dizajnin Industrial, nenin 79 të Ligjit nr.8/L-075 për Markat Tregtare, dhe nenit 297 të LPK-së. Gjykata vleron se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, përkundër që ka vërtetuar faktin se është bartës i dizajnit industrial nr.209 dhe markën tregtare tredimensionale me nr. regjistrimit 28291, i njëjti nuk e ka vërtetuar në tërsi pretendimet për shkelje të dizajnit industrial dhe markës tredimensionale si rezultat i veprimeve të palës kundërpropozuese. Gjykata gjen se produktet e vendosura nga kundërshtari i sigurimit në artikullin tregtar, janë produkte që bartin markën tregtare të cilën kundëpropozuesi veqse e ka regjistruar pranë API-së, andaj në këtë fazë të procedurës caktimi i masës së sigurisë, do të ishte në kundërshtim me të drejtat e fituara të kundërpropozuesit nga neni 9 i LMT-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sikurse pretendohet në ankes, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshëm faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së saj. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i masës së sigurimit ka propozuar gjykatës caktimin e masës së sigurimit duke urdhëruar paditurin/kundërshtarin e masës së sigurimit që ti ndalohet çdo aktiviteti cili shkel dizajnin industrial nr.209 apo markën tregtare nr.28291 përfshirë prodhimin, importimin, eksportimin, vendosjen në treg, shitjen a po magazinimin të produkteve shkelëse.

Mirëpo vet fakti se edhe kundërshtari i masës së sigurimit pranë API-së, ka të regjistruar markën tregtare për produktet e vendosura në qarkullim tregtar, Kolegji vlerësoi se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit nga neni 68 i LDI-së, neni 79 i LMT-së dhe neni 297 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se Aktvendimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave kontestimore nga neni 181 dhe 182 (n) të LPK-së. Kolegji konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit dhe në anën tjetër janë dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket besueshmërisë së ekzistimit të kërkesës për të vendosur në caktimin e masës së sigurimit në vështrim të nenit 68 të LDI-së, nenit 79 të LMT-së dhe nenit 297 pika a) dhe b) të LPK-së.

Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë me të drejt ka dhënë arsyet në pretendimet e paditësit/propozuesit se nuk janë vërtetuar në tërësi pretendimet për shkelje të dizajnit dhe markës tredimensionale nga ana e kundërshtarit të sigurimit. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se kundërshtari i sigurimit ka të regjistruar markën tregtare në API, dhe në produktet e tij krahasuar me dizajnin dhe markën tregtare të regjistruar nga proozuesi i sigurimit, nuk mund të vërtetohet plotësisht se është shkelur dizajni apo marka tregtare, prandaj Kolegji vlerësoi se nuk janë të mjaftueshme dhe të bazuara pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurimit se ekziston identitet midis produkteve të mbrojtura sipas markës së regjistruar nga paditësi dhe produkteve të cilat i përdor kundërshtari i sigurimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë, konsideron se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të aktvendimit në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) e lidhur me nenin 209 par.1 nën pikën b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.987/24 datë 08.05.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Krenar Berisha